



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLA.nr.16/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Bujar Muzaqi, dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], me vendbanim në Itali, të parashtruar kundër Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ, në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.09.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa ZLAnr.16/2025, e datës 05.09.2025, e ushtruar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Itali, paraqitur kundër Vendimit nr.01/2318-2025, të datës 03.09.2025, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 05.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Itali, me të cilën pretendohet se i është refuzuar regjistrimi si votues jashtë Kosovës nga ana e KQZ-së, përkundër që sipas parashtruesit të ankesës i plotëson të gjitha kriteret për regjistrim i cili thekson se ka prezentuar dokumentet valide edhe të Republikës së Kosovës dhe të vendit ku punon dhe banon.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, sqaron gjithë ecurinë e procesit nga ana e saj duke theksuar se shtetas [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDAKTUAR] për refuzimin e aplikimit të tij me arsyen e refuzimit: "Dokumenti i adresës së banimit është i palxueshëm", meqë nga dëshmia e bashkangjitur nuk vërehej asnjë e dhënë në të dhe si e tillë nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara në rregulloren sikurse përcaktohet në nën paragrafin 4.4, të nenit 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku thuhet: "aplikuesi fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës", sikurse në nën paragrafin 4.1. Në përgjigje po ashtu theksohet se KQZ ka pranuar kundërshtimin administrativ të [REDAKTUAR] parashtruar përmes emailit në email adresën kundershtimi.vjk@kqz-ks.org, me datë 30.08.2025, ora: 10:34. Në kundërshtim, i njëjti ka paraqitur pretendimet si Vijn: "Ankohem fuqishëm për refuzimin e kërkesës sime për regjistrim si votues jashtë vendit për arsyen e mos lexueshmërisë së adresës së

vendbanimit në fotot e dërguara në aplikim." Së bashku me kundërshtimin, parashtruesi ka bashkëngjitur dëshminë e adresës. KQZ shton se ka themeluar Komisionin për Kundërshtim Administrativ (Komisioni), i cili ka shqyrtuar të gjitha kundërshtimet e pranuar, përfshirë edhe kundërshtimin e paraqitur nga votuesi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pretendimeve të votuesit, Komisioni ka konstatuar se kundërshtimi administrativ rekomandohet të refuzohet, pasi nuk përmban elementet e kërkuara në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës si dhe në udhëzimet e dhëna përmes email-it zyrtar. Në veçanti, është e detyrueshme që bashkëngjitja e fotografisë së aplikuesit me dokument identifikues të Kosovës në dorë të jetë pjesë e kundërshtimit, kusht ky që në rastin konkret nuk është përmbushur.

Komisioni e ka paraqitur rekomandimin në mbledhjen e KQZ-së nr.54/2025, të mbajtur më 03.09.2025, ku ndër të tjera është rekomanduar refuzimi i kundërshtimit të parashtruesit. Pas shqyrtimit, KQZ ka miratuar rekomandimin e Komisionit me vendimin nr. 01/2318/2025, duke refuzuar kundërshtimin administrativ të ankuesit. I njëjti është njoftuar me email më 03.09.2025 lidhur me vendimin e KQZ-së, si dhe me të drejtën e ushtrimit të ankesës në PZAP brenda afateve ligjore.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, dhe përgjigjes së dhënë nga KQZ, vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave,

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, dhe vendimin me nr. Protokolli 01/2318-2025 datë 03.09.2025, të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, dhe bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *"4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1..."*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se parashtruesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, ka bashkëngjitur dokumentet e kërkuara, përkatësisht: fotografinë e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, fotografinë e dokumentit të identifikimit të Italisë, si dhe dokumentin që pretendonte të dëshmonte adresën e tij të banimit jashtë Kosovës. Megjithatë, nga verifikimi i këtyre dëshmive paneli vëren se dokumenti i adresës së banimit ishte i palexueshëm dhe se ai dokument nuk mund të identifikohet asnjë e dhënë që vërteton adresën e aplikuesit jashtë Kosovës.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresës së vendbanimit të aplikuesit, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nenin paragrafin 4.4, të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 4 pika 4.4 e lidhur me paragrafi 5 pika 5.3 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.16/2025, datë 09.09.2025

Kryesues i Panelit,
Hariz Hoti



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.77/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rustem Thaqi dhe Franciska Zhitija – Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës Brahim Boshnjaku, me vendbanim në Itali, paraqitur kundër Vendimit të KQZ-së nr.01/2318-2025 dt.3.09.2025, për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ, në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 12 Tetor 2025, tani duke vendosur sipas ankesës së Brahim Boshnjakut, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZLA.nr.16/2025 dt.9.09.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.09.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Brahim Boshnjakut, me vendbanim në Itali, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZLA.nr.16/2025 dt. 9.09.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZLA.nr.16/2025 të dt.9.09.2025, është refuzuar e pa bazuar ankesa ZLA nr.16/2025 dt.5.09.2025, e ushtruar nga Brahim Boshnjaku, me vendbanim në Itali, paraqitur kundër Vendimit nr. 01/2318-2025 dt.3.09.2025, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më dt.12 Tetor 2025.



Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP-së, Brahim Boshnjaku, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it, përkatësisht, siç thekson në të, “konsideroj se me të dy vendimet më është bërë e padrejtë mos regjistrimi si votues jashtë Kosovës edhe pse kam ofruar dokumentat e identitetit dhe se jam në rregull me kushtet që kërkohen për regjistrim për votuesit jashtë vendit, me propozim që të shqyrtohet ankesa dhe të vendoset në favor timin”.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 5.09.2025 ka pranuar një ankesë nga Brahim Boshnjaku, me vendbanim në Itali, me të cilën pretendohet se i është refuzuar regjistrimi si votues jashtë Kosovës nga ana e KQZ-së, përkundër që sipas parashtresës të ankesës i plotëson të gjitha kriteret për regjistrim i cili thekson se ka prezentuar dokumentet valide edhe të Republikës së Kosovës dhe të vendit ku punon dhe banon. Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, sqaron të gjithë ecurinë e procesit nga ana e saj duke theksuar se shtetasi Brahim Boshnjaku, ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit (braha.agoni@hotmail.com) për refuzimin e aplikimit të tij, me arsyen e refuzimit: “Dokumenti i adresës së banimit është i palexueshëm” me që nga dëshmia e bashkangjitur nuk vërehej asnjë e dhënë në të dhe si e tillë nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara me rregulloren sikurse përcaktohet në nënp.4.4, të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, ku janë specifikuar kriteret, respektivisht kushtet përkatëse që kërkohen për regjistrim dhe votim jashtë vendit, i cili më pas ka paraqitur kundërshtimin përkatës, me pretendimet si në kundërshtimin e tij, por i cili është refuzuar nga arsyet e mësipërme të dhëna në vendimin e sipër përmendur të KQZ-së, të dt.3.09.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe vendimin përkatës të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë dhe i ligjshëm dhe bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pa bazuar, pasi që parashtresë i saj, gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas par.4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se “4.



Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ-së, bëhet si në vijim: 4.1 Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4 Fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nënp.4.1 ..”. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe përgjigjes së KQZ-së, PZAP-i arriti në përfundimin se parashtruesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara, përkatësisht fotografinë e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, fotografinë e dokumentit të identifikimit të Italisë, si dhe dokumentin që pretendonte të dëshmonte adresën e tij të banimit jashtë Kosovës. Megjithatë, nga verifikimi i këtyre dëshmimeve Paneli vëren se dokumenti i adresës së banimit ishte i palexueshëm dhe se ai dokument nuk mund të identifikohet asnjë e dhënë që vërteton adresën e aplikuesit jashtë Kosovës. Në këto rrethana PZAP vlerësoi se parashtruesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresës së vendbanimit të aplikuesit, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nënp.4.4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të nxjerrë nga KQZ. Ndaj, nga arsyet e sipër theksuara dhe duke u bazuar në nenin 17 par.3, 118 par.1, nenin 119 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 3, par.4.4 e lidhur me par.5 pika 5.3 e Rregullores të sipër cituar dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me refuzimin e ankesës si të pa bazuar, përkitazi me mos përfshirjen në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më dt.12 Tetor 2025, me që vlerëson se vendimi i këtij organi nuk është i kundërligjshëm dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe as me Rregulloret a legjislacionin sekondar të KQZ dhe PZAP-it.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht, janë të paqëndrueshme.



Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, PZAP me të drejtë ka arritur në përfundimin se parashtruesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike të KQZ-së, ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara, të specifikuara si më lartë, mirëpo, nga verifikimi i këtyre dëshmime Paneli, veç tjerash, vëren se dokumenti i adresës së banimit ishte i palexueshëm dhe se ai dokument nuk mund të identifikohet asnjë e dhënë që vërteton adresën e aplikuesit jashtë Kosovës, pra, rezulton qartë se parashtruesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresës së banimit të aplikuesit, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me dispozitat e lartë cituara.

Prandaj, nga këtu, kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe lidhur me rastin konkret nuk është cenuar e drejta zgjedhore dhe ndonjë e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë shkelur parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e ankimuar të PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën e parashtruar nga paraqitësi i sipër përmendur, kundër vendimit të kontestuar e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura, e në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-77/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

PZAP.

PRISTINA

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTGUKIM

11. 09. 2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

[Signature]

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioea ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

12. 09. 2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtači)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.